



BiEPAG

*prill 2024*

**Trekëndëshi i (mos)besimit:**

# **AKSIONET E ZGJERIMIT TË HUNGARISË NË SERBI DHE KOSOVË**

**Autori:**

*BiEPAG bashkëpunëtor, Alejandro Esteso Pérez*

---



---

# 1. Hyrje

---

Që nga rimarrja e pushtetit ekzekutiv në vitin 2010, kryeministri hungarez Viktor Orban i ka kthyer përmbys punët e brendshme politike dhe sociale të vendit të tij, duke e bërë Hungarinë pengesën kryesore në zemër të makinerisë vendimmarrëse dhe operacionale të Bashkimit Evropian (BE). Në kërkimin e tij për aleatë dhe diversifikimin e burimeve, Orban është shumëdimensional në marrëdhëniet e tij me gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, ndër të cilat Serbia padyshim spikat si partneri i tij i preferuar. Marrëdhëniet vëllazërore të Budapestit me Beogradin, kryesisht të forcuara nga lidhjet ndërvetjake mes Orbanit dhe presidentit serb Aleksandar Vuçiç, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të qasjes së tij ndaj zgjerimit të BE-së. Gjithsesi, në dritën e këtij partneriteti të privilegjuar shfaqen disa shqetësime jo vetëm për sa i përket vizionit të Budapestit në lidhje me zgjerimin, por edhe kur bëhet fjalë për lidhjet e tij politike me vendet e tjera të rajonit – ku Kosova shquhet si rasti më kritik.

Aktualisht Hungaria gjendet në një nyje trekëndore mes Serbisë dhe Kosovës, e ndërtuar mbi premisën se ruajtja e marrëdhënieve dypalëshe në mënyrë të barabartë me të dy vendet mund të komprometojë lidhjet e saj të mirëushqyera me Beogradin. Për të shmangur një gjë të tillë, Hungaria do të miratojë një politikë që mbështet qëllimet e brendshme dhe ndërkombëtare të Serbisë, edhe nëse kjo ka implikime negative për interesat kombëtare të Kosovës, gjë që e vë nën vëzhgim të vazhdueshëm njohjen e hapur të Kosovës nga Hungaria.

---

## 2. Vitet e Orbanit: Politika e Jashtme dhe e Zgjerimit e Hungarisë që nga viti 2010

---

Viktor Orban e ka vënë veten në krye të një paradigme të re të qeverisjes dhe vlerave që gradualisht kanë fituar simpati në të gjithë BE-në dhe më gjerë. Shumicat e vazhdueshme dërrmuese që partia e tij politike, Fidesz, ka fituar në parlamentin hungarez gjatë 14 viteve të fundit, i kanë dhënë kryeministrit dhe ekzekutivit të tij carta bianca të bëjnë dhe të zhbëjnë sipas gjykimit të tyre – edhe në kurriz të shtetit të së drejtës, ndarjen e pushteteve dhe arkitekturën institucionale liberal-demokratike. Në kuadër të idealit të tij të vetëquajtur qeverisës, Shtetit joliberal<sup>1</sup>, Orban ka minuar ngadalë marrëdhëniet e qëndrueshme të Hungarisë me Perëndimin, duke u vëllazëruar me autokratë me të njëjtin qëndrim si të tijin në Lindje – si Kina, Rusia dhe republikat e Azisë Qendrore – dhe duke krijuar një qasje pragmatike për marrëdhëniet me jashtë. Si përgjigje për rënien globale të rendit botëror neoliberal ekonomik dhe politik, kryeministri hungarez beson se bota është e destinuar të veprojë në blloqe dhe mbron nevojën për të ndërtuar ura ndërmjet këtyre blloqeve duke përdorur një model të bazuar në lidhje.

Në përpjekjen për të reduktuar varësinë e Hungarisë ndaj tregtisë me Perëndimin dhe për t'i mundësuar vendit të tij të arrijë partnerët e BE-së përmes rritjes ekonomike, Orban ka kërkuar diversifikimin përmes krijimit të aleancave jo tradicionale, me synimin për ta bërë Hungarinë një lidhje mes universeve të Perëndimit dhe Lindjes për sa i përket vlerave dhe qeverisjes. Paralelisht me këtë, Orban ka vijuar me bashkëpunimin me Grupin e Vishegradit, i njohur edhe si Katërshja e Vishegradit, ku bëjnë pjesë Republika Çeke, Hungaria, Polonia dhe Sllovakia. Për të, bashkëpunimi brenda Vishegradit përfaqëson ruajtjen e interesave të përbashkëta në kohë të presionit të lartë migrator dhe ndryshimeve të mëdha gjeopolitike, bazuar në besimin e përbashkët se "Evropianët Qendrorë janë ata që respektojnë vlerat origjinale të BE-së: familjen, fenë dhe sovranitetin."

Një tjetër nga shqetësimet kryesore të politikës së jashtme të

---

<sup>1</sup> 'Fjalimi i Kryeministrit Viktor Orbán në Universitetin e Lirë Veror të 25-të Bálványos dhe në Kampin Studentor', 2014. <https://2015-2019.kormany.hu/en/the-prime-minister/the-prime-minister-s-speeches/prime-minister-viktor-orban-s-speech-at-the-25th-balvanyos-summer-free-university-and-student-camp>

Hungarisë qëndron me fqinjët e saj jashtë BE-së, përkatësisht gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Qeveria Orban ka shprehur tradicionalisht pikëpamjen se drejtimi kryesor i zgjerimit të BE-së duhet të jetë drejt Ballkanit Perëndimor, pasi një krah i qëndrueshëm dhe i zhvilluar në juglindje është në interes të vetë Hungarisë.<sup>2</sup> Interesat strategjike të politikës së jashtme të Budapestit në Ballkanin Perëndimor janë të shumëfishta, duke përfshirë tregtinë dhe investimet, mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, sigurinë energjetike dhe stabilitetin e rajonit. Megjithatë, tre dimensione kryesore strukturojnë pozicionin e favorshëm të Hungarisë ndaj anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE: ai ekonomik, ai i sigurisë dhe ai ideologjik.

Pavarësisht ambicieve të Budapestit për zgjerimin e BE-së, jo të gjitha vendet kanë të njëjtën rëndësi në kontekstin rajonal ose përballë interesave të Budapestit, dhe për këtë arsye marrëdhëniet me gjashtë partnerët nuk kultivohen në të njëjtën masë.

## 2.1. I njëjti avaz: Marrëdhëniet Hungari-Serbi

Tre dimensionet që shprehin interesin e politikës së Hungarisë në Ballkanin Perëndimor evidentohen më së qarti në Serbi, ku fusha ekonomike është më e rëndësishmja. Hungaria është partneri i pestë më i madh tregtar i Serbisë në nivel botëror, ndërsa Serbia renditet e shtatëmbëdhjeta për sa i përket partnerëve tregtarë të Hungarisë, shkëmbimi tregtar i të cilave arrin në 3.6 miliardë euro, pesë herë më i madh se një dekadë më parë.<sup>3</sup> Një pjesë veçanërisht strategjike e marrëdhënieve miqësore ekonomike mes dy vendeve shfaqet në fushën e energjisë, e zgjeruar edhe më tej në kuadër të pushtimit rus të Ukrainës dhe vendimit të shumicës së shteteve anëtare të BE-së për të diversifikuar burimet e tyre të energjisë duke iu larguar Moskës. Mirëpritja e burimeve energjetike pavarësisht se kush është furnitori është një parim i rëndësishëm në qasjen e të dy vendeve ndaj marrëdhënieve ekonomike - një parim që parapriu bojkotin e BE-së ndaj energjisë ruse.

Edhe në dimensionin e sigurisë, Hungaria dhe Serbia tregojnë nivele të lartakonvergjence. Të dy vendet e shohin luftën kundër migracionit të paligjshëm dhe azilkërkuesve si një prioritet kyç në aspektin ekonomik, sociologjik dhe demografik. Ndonëse vendimi i Budapestit për të ndërtuar një gardh prej katër metrash përgjatë kufirit të tij me Serbinë për të penguar kalimin e emigrantët shkaktoi një përgjigje të hidhur në fillim, Beogradi nuk ndërmori asnjëherë kundërmasa ndaj Hungarisë, duke sugjeruar se marrëdhëniet dypalëshe mbetën të qëndrueshme dhe se Serbia ishte e vendosur të korrte frytet dhe përfitimet afatgjate nga aleanca së Hungarisë në kryqëzatën e tyre të përbashkët kundër imigracionit.

2 "Hapi strategjik i bërë përpara në marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Hungarisë", 2023. <https://www.srbija.gov.rs/vest/en/208572/strategic-step-forward-made-in-relations-between-serbiahungary.php>

3 Po aty.

Konvergjenca ideologjike e sistemeve qeverisëse të Hungarisë dhe Serbisë është e mishëruar më së miri në identitetin politik të udhëheqësve të tyre. Viktor Orbn dhe Aleksandar Vuçiq çimentuan kontrollin e tyre politik pothuajse paralelisht, kur që të dy, si kryeministri hungarez ashtu edhe presidenti serb, rifituan pushtetin në fillim të viteve 2010, me pothuajse dy vjet diferencë. Të dy udhëheqësit kanë të njëjtin stil populist të krahut të djathtë, autokratik, si dhe një qasje supremacie të kombit të tyre ndaj vendeve të tjera. Ata janë prirur të përdorin politikat gjithnjë e në rritje centraliste dhe joliberalë të njëri-tjetrit në fushën e lirisë së medias, atë të të drejtave të njeriut dhe të shtetit të së drejtës.<sup>4</sup>

## 2.2. Njohje të vjetra, probleme të reja: Marrëdhëniet Hungari-Kosovë

Ashtu si me Serbinë, tre dimensionet që strukturojnë interesin e politikës së Hungarisë në Ballkanin Perëndimor e gjejnë shprehjen e tyre edhe në Kosovë – ndonëse në një shkallë dukshëm më të vogël. Në lëmin ekonomik, tregtia dypalëshe është pothuajse trefishuar që nga viti 2015 dhe pritet të arrijë nivelin më të lartë të të gjitha kohërave, me telekomunikacionin dhe pajisjet audio që renditen si sektori më i rëndësishëm.<sup>5</sup> Megjithatë, në përgjithësi, Kosova mbetet një partner i pakonsiderueshëm në marrëdhëniet tregtare të Hungarisë, ndoshta për shkak të problemeve me sundimin e ligjit, të cilat vënë në rrezik klimën e investimeve. Lëmi i sigurisë është një tjetër fushë parësore me interes. Ai arriti kulmin e tij gjatë krizës së refugjatëve të vitit 2015, ku Kosova për shkak të vendndodhjes së saj si vend tranziti në ‘rrugës ballkanike’ përforconte rolin e saj në luftën e Budapestit kundër emigrimit masiv. Gjithsesi, Kosova konsiderohej si vend tranzit më pak i rëndësishëm se shtetet e tjera në rajon, si Serbia dhe Maqedonia e Veriut, gjë që bëri që të kufizohej ndikimi i Prishtinës ndaj Hungarisë. Statusi i Kosovës si vend i origjinës për mijëra azilkërkues e reduktoi edhe më shumë ndikimin e saj. Dimensioi ideologjik është më pak i qartë në Kosovë. Kjo pasqyron mbështetjen e madhe dhe të hapur që shumica e partive politike të Kosovës shprehin ndaj BE-së dhe sistemit të saj politik relativisht të paqëndrueshëm dhe paparashikueshmërisë, mbështetje që redukon mundësitë që autoriteti të përqendrohet në duart e një partie apo individi të vetëm.<sup>6</sup>

4 Maja Živanović, ‘Lideri serb “Ndjek Orbanin” në kontrollin e mediave – Freedom House’, *Balkan Insight*, 2023. <https://balkaninsight.com/2019/06/05/serbian-leader-following-orban-in-controlling-media-freedom-house/>

5 ‘Tregtia e Hungarisë pritet të jetë rekord në vitin 2023 me këtë vend të vogël’, *Daily News Hungary*, 2023. <https://dailynewshungary.com/hungarys-trade-expected-to-be-record-breaking-in-2023-with-this-small-country/>

6 Agon Maliqi, ‘Tranzicioni drejt çfarë? Demokracitë e Ballkanit Perëndimor në një gjendje ekuilibri joliberal’, *Sbunker*, 2020. <https://sbunker.net/uploads/sbunker.net/files/2020/December/04/Transition-to-what-Western-Balkans-democracies-in-a-state-of-iliberal-equilibrium1607078207.pdf>

---

## 3. Zgjerim à la Orban: Angazhimi i Hungarisë me Serbinë dhe Kosovën

---

Pavarësisht se ka lidhje të konsoliduara diplomatike me Serbinë dhe Kosovën, marrëdhëniet e Hungarisë me të dy vendet janë të pabarabarta – gjë që lidhet drejtpërsëdrejti me shkallën e konvergjencës rreth interesave strategjike të politikës së jashtme të Budapestit. Ndërkohë që Serbia zë një pozicion plotësisht konvergjent në listën prioritare të Hungarisë – për sa i përket lëmit ekonomik, të sigurisë dhe atij ideologjik – Kosova, në pjesën më të madhe, dështon në këtë drejtim. Në kontekstin aktual gjeopolitik, ia vlen të shtrojmë pyetjen se cili do të jetë roli aktual dhe i ardhshëm i Hungarisë si një bosht strategjik ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Qëndrimi hungarez ndaj ngjarjeve kryesore që përcaktonin dialogun Beograd-Prishtinë në vitin 2023 – përkatësisht zgjedhjet vendore në katër komunat në veri të Kosovës dhe episodet e dhunës që pasuan, përfshirë këtu rrëmbimin e tre policëve të Kosovës nga forcat serbe dhe sulmin e Banjskës më 24 shtator – u bë më dinamik gjatë fundit të vitit. Budapesti u zhvendos dukshëm nga ruajtja e një profili të ulët për të shmangur kompromentimin e lidhjeve të saj me Serbinë, drejt nisjes së një loje delikate të levave dhe pengesave në favor të Beogradit. Kërkesa që Orban i bëri Aleksandër Vuçiçit u konsiderua si vendimtare në lirimin e tre policëve, gjë që bëri që Hungaria ta tregonte veten si një ndërmjetës përherë e më i rëndësishëm diplomatik mes Beogradit dhe Prishtinës – ndonëse, të paktë për momentin, nëpërmjet angazhimit jozyrtar.<sup>7</sup> Gjithsesi, mund të vihet në dyshim paanshmëria e Hungarisë: ekzekutivi i Orbanit ka luajtur një rol kyç në mbrojtje të Serbisë ndaj sanksioneve të mundshme të BE-së – ku kemi një qasje tërësisht të ndryshme ndaj rastit të Kosovës, kundër së cilës Budapesti nuk ngurroi të mbështeste masat ndëshkuese që ndërmori Brukseli.

Në kuadër të aplikimeve të vazhdueshme të Kosovës në Këshillin e Evropës (KiE) dhe BE-së, ekziston frika se Hungaria do të vazhdojë me qëndrimin e saj pengues për të përmbushur pritshmëritë e Beogradit. Qeveria hungareze

---

<sup>7</sup> Intervistë me Anna Orosz, studiuese në Institutin Hungarez të Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Budapest, 6 nëntor 2023.

iu zotua Serbisë se nuk do të mbështeste asnjë nga përpjekjet e Kosovës për t'iu bashkuar institucioneve evropiane dhe më pas votoi kundër anëtarësimit të Kosovës në KiE.<sup>8</sup> Edhe pse Kosova ia arriti, gjithsesi, të siguronte shumicën e nevojshme prej dy të treta të 46 vendeve anëtare, u bë e qartë se Budapesti ishte i gatshëm të merrte hapur anën e Serbisë pavarësisht reagimeve diplomatike, duke nënvizuar se njohja e Kosovës nuk do të thotë domosdoshmërisht mbështetje për të. Si parapritë për hapat e ardhshëm të anëtarësimit të Prishtinës, Budapesti mbetet i mendimit se Kosovës do t'i duhet të zgjidhë pengesat strukturore, mbi të gjitha marrëdhëniet e saj me Serbinë, para se të mund të bëjë përparim drejt integritimit evropian.

Në nivel BE-je, Hungaria e Orbanit e ka bërë politikën e zgjerimit një nga prioritetet e saj kryesore dhe do të vazhdojë të ndjekë vizionin e saj të zgjerimit brenda Bashkimit në disa dimensione. Përpara zgjedhjeve të ardhshme evropiane në qershor, Budapesti e ka bërë të qartë se dëshiron të mbajë portofolin e zgjerimit, por është i vetëdijshëm se kjo nuk ka gjasa duke pasur parasysh kritikën që ka marrë komisioneri aktual, diplomati hungarez Oliver Várhelyi. Paralelisht me këtë, presidenca gjashtëmujore e Hungarisë në Këshillin e BE-së ka të ngjarë të vazhdojë në korrik siç është planifikuar, por qeveria hungareze do ta ketë mjaft të vështirë të zbatojë programin e saj, e jo më të zbatojë udhërrëfyesin e saj të zgjerimit. Kur Hungaria të marrë presidencën menjëherë pas zgjedhjeve evropiane, ajo do të ketë kapacitet të kufizuar për të bashkëvepruar me Komisionin e ardhshëm Evropian, duke u marrë kryesisht me detyrën e funksionimit në rregull të BE-së derisa të konstituohen të gjitha institucionet e unionit. Gjithsesi, gjatë kësaj kohe, Budapesti do të vazhdojë të ushqejë strategjinë e tij të zgjerimit përmes rrjetit të konsoliduar të këshilltarëve për çështjet e integritimit në BE, të vendosur në të gjitha qeveritë e Ballkanit Perëndimor – një avantazh diplomatik që mund të kthehet në bumerang në kontekstin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

---

8 Alice Taylor, 'Serbia thotë se Hungaria do të votojë kundër anëtarësimit të Kosovës në BE dhe KiE', Euractiv, 2023. [https://www.euractiv.com/section/politics/news/serbia-says-hungary-will-vote-against-kosovo-eu-coe-membership/?utm\\_source=flipboard&utm\\_content=user%2FEURACTIV](https://www.euractiv.com/section/politics/news/serbia-says-hungary-will-vote-against-kosovo-eu-coe-membership/?utm_source=flipboard&utm_content=user%2FEURACTIV)



---

## 4. Përfundime: një mesazh për Brukselin

---

Konsolidimi i aleancave të reja gjeopolitike dhe ideologjike në nivel global e ka bërë rolin e Shteteve matrapazë Anëtare të BE-së, si Hungaria, gjithnjë e më të rëndësishëm në një Union 27-vendësh, të cilit shpesh i mungon kapaciteti për të reaguar në një mënyrë të shpejtë dhe me një zë. Ky vit pritet të jetë një vit dinamik në aspektin elektoral, me zgjedhje të rëndësishme parësore si në Evropë ashtu edhe në Shtetet e Bashkuara. Internacionalja joliberalë, të cilën Hungaria e kryeson në Evropë, pret plot shpresë një rikthim të mundshëm të Donald Trumpit në Shtëpinë e Bardhë, duke nënkuptuar një kthesë të menjëhershme në prioritetet e politikës së jashtme dhe një zhvendosje dramatike të fondeve, të kapitalit njerëzor dhe të garancive të sigurisë larg Evropës.

Procesi i normalizimit ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, si dhe ofertat e të dyja vendeve për integrimin evropian, do të goditen nga ky realitet i ri dhe kjo do të kërkojë që BE të flasë më sinqerisht dhe me më shumë guxim kundër partnerëve jodemokratikë. BE ka vazhduar kryesisht me politikën e saj të qëndrimit të butë ndaj Serbisë, si nga frika se Serbia mund të afrohet më shumë me sferat autoritare të ndikimit të Ruisë dhe Kinës, ashtu edhe nga ngurrimi se mos dëmton ekuilibrin aktual gjeopolitik të Beogradit. BE-së dhe shteteve të saj anëtare i mungon nisma për të vendosur sanksione kundër Beogradit, nga të cilat Hungaria përfiton qartë. Por është pikërisht kundërshtimi i drejtpërdrejtë i Hungarisë ndaj vendosjes së sanksioneve kundër Serbisë, bazuar në motive që dukshëm shkojnë përtej atyre ekonomike dhe gjeopolitike, që BE është duke përdorur për të justifikuar mungesën e vullnetit - dhe, rrjedhimisht, paaftësinë e saj - për t'i kërkuar llogari Beogradit.

Duket se më shumë se një trekëndësh stabiliteti të supozuar, marrëdhënia mes Serbisë, Kosovës dhe Hungarisë është një marrëdhënie besimi dhe mosbesimi. Krahu i saj më i fortë, d.m.th., lidhja hungareze-serbe, pritet të lulëzojë në një arenë globale ku po rritet autoritarizmi, ndërsa krahu më i dobët, Kosova, ka të ngjarë të vazhdojë përpjekjet e saj pa rritje dhe përmirësim të mbështetjes nga shtetet anëtare të BE-së.

## 5. Rekomandime për politikën

**o1 Entuziazmi i Hungarisë për zgjerimin duhet pasur parasysh—por duhet të zbatohen masa paraprake.** Shtetet Anëtare duhet të pranojnë shtysën e Hungarisë për politikën e zgjerimit të BE-së dhe duhet të mbështesin axhendën e saj për sa kohë që ajo i përmbahet parimeve të Bashkimit për demokracinë, barazinë dhe sundimin e ligjit. Për sa i përket vendeve kandidate dhe kandidate potenciale, Shtetet Anëtare duhet të kenë një qasje objektive të bazuar në realizimin e reformave të vendeve aplikante dhe arritjet e bazuara në meritë. Për më tepër, shtetet anëtare nuk duhet të angazhohen në pengimin e progresit të kandidatëve dhe kandidatëve potencialë për shkak të çështjeve dypalëshe, për hir të ruajtjes së natyrës meritokratike të procesit.

**o2 Aplikimi i Kosovës për në BE duhet të ecë përpara.** Këshilli i Punëve të Jashtme i BE-së, ose Komiteti Politik dhe i Sigurisë (KPS) në emër të tij, duhet të shtrojë për diskutim kandidaturën e Kosovës, të paraqitur në dhjetor 2022, dhe t'i kërkojë Komisionit Evropian të nxjerrë një Opinion për këtë çështje.

**o3 Mosnjohja nuk mund të ndalë progresin.** Kosova dhe aleatët e saj anëtare të BE-së duhet të këmbëngulin për zbatimin e Nenit 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) përmes të njëjtës rrugë që u aktivizua për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit të Kosovës (MSA). Kjo dispozitë do t'i bënte të mundur Këshillit të BE-së si subjekt ligjor, në vend të 27 shteteve anëtare, të luante rolin e homologut të Kosovës. Megjithatë, kjo do të shërbente vetëm si një rrugë e shkurtër ligjore në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme, pasi në fund të fundit është e nevojshme që të gjitha shtetet anëtare të ratifikojnë secila më vete traktatin e anëtarësimit të Kosovës – për të cilin vetëm një marrëveshje më e qëndrueshme, me shumë gjasa duke përfshirë edhe Serbinë, mund të bënte që pesë shtetet që nuk e njohin Kosovën të mbështesnin lëvizjen.

**o4 Marrja me të mirë e Serbisë dëmton pavarësinë dhe aftësinë e BE-së për të reaguuar.** Shtetet anëtare duhet të tregojnë një qëndrim më të ashpër ndaj hapave prapa që po bën Serbia në drejtim të demokracisë, të kuptojnë pengesat që ngre ajo në dialogun me Kosovën dhe të lënë mënjanë skepticizmin e tyre për të ndëshkuar këtë prirje shqetësuese. Ka prova të

qarta se mosndëshkimi i Serbisë trimëron Hungarinë, dhe anasjelltas. Për të anashkaluar veton e mundshme hungareze kundër sanksioneve të mundshme ndaj Beogradit, qoftë përmes ngrirjes së fondeve sipas Instrumentit për Ndhimën e Para-Aderimit (IPA) III, ngrirjes së aseteve ose ndalimeve të udhëtimit, Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa politike dhe ekonomike të një natyre dypalëshe. Zbatimi paraprak i sanksioneve do t'i hiqte Hungarisë një nga pikat kryesore të negociatave në nivel BE.

**05**

**Sulmi në Banjska është çështje e BE-së dhe duhet të hetohet tërësisht.** Komisioni Evropian duhet të ndjekë më tej rezolutën e Parlamentit Evropian të 19 tetorit dhe të kryejë një hetim të pavarur për ngjarjet e 24 shtatorit në fshatin Banjskë për të identifikuar faktet dhe motivet e sulmit dhe, në përputhje me rrethanat, të vendosë sanksione kundër autorëve të tij.

**06**

**Ekspertiza kombëtare e BE-së mund të ndihmojë për mbajtjen nën kontroll të ndikimit të Hungarisë në rajon.** Shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë krijimin e marrëveshjeve dypalëshe me vendet e Ballkanit Perëndimor për të ofruar asistencë teknike dhe politike për ministritë dhe institucionet që merren me integrimin evropian, ashtu siç bën Hungaria. Rrjeti rajonal i këshilltarëve rajonalë i Budapestit aktualisht gëzon shumë pushtet dhe ekziston rreziku që informacionet e ndjeshme të bien në duar të gabuara – me pasoja të drejtpërdrejta në autoritetin e BE-së për të ndërmjetësuar, për shembull, në dialog. Po ashtu, qeveritë e Ballkanit Perëndimor duhet të kërkojnë ekspertizë këshillimore nga shtetet të besuara anëtare për të reduktuar ndikimin e tepruar të ekspertëve të caktuar nga Hungaria. Në mënyrë të ngjashme, në nivel BE-je, Komisioni Evropian duhet të marrë parasysh rritjen e pranisë së tij teknike nëpërmjet Asistencës Teknike dhe Shkëmbimit të Informacionit (TAIEX) dhe instrumenteve të bashkëpunimit të binjakëzimit.

---

# Rreth nesh

---

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the Balkans - EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotërojnë pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave. Ky grup përbëhet nga studiues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber (Kordinator), Bojan Baća, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Nikola Dimitrov, Vedran Džihic, Richard Grieveson, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić (Asistent kordinator), Srđan Majstorović, Jovana Marović, Zoran Nechev, Damir Kapidžić, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nikolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergji Vurmo, Natasha Wunsch.

**<https://biepag.eu>**

Kontakt: [info@biepag.eu](mailto:info@biepag.eu)

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha gjithëpërfshirëse - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritetit në BE. Fondacioni mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platforma ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

**[www.balkanfund.org](http://www.balkanfund.org)**

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive,  
[aleksandra.tomanic@balkanfund.org](mailto:aleksandra.tomanic@balkanfund.org)

---

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe arsimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar. Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon rregullisht konferenca dhe seminare ndërkombëtare për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore

**<http://csees.uni-graz.at/>**

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER

Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore,

[florian.bieber@uni-graz.at](mailto:florian.bieber@uni-graz.at)

*©Fondi Evropian për Ballkanin 2024. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë vetëm ato të autorit(ve) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.*

